

Emri i Lëndës : Hyrje në Financë							
Kodi	Tipi	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
EMS 115	D	Vjeshtë	3.00	1.00	0.00	3.50	5.00
<b>Lektori</b>		Kriselda Gura, MSc					
<b>Asistenti</b>							
<b>Gjuha e kursit</b>		Anglisht					
<b>Niveli i lëndës</b>		Bachelor					
<b>Përshkrimi</b>		Qëllimi i kësaj lënde është të sigurojë një hyrje gjithëpërfshirë të parimeve themelore të financës, dukë vënë theksin tek financat e korporatave. Konceptet e studiuara në këtë lëndë do të shërbejnë si bazë për kurset e tjera si investimet dhe financat e korporatave. Fokusi i kësaj lënde janë tregjet financiare dhe mjetet dhe njohuritë të cilat nevojiten për të kuptuar sesi këto tregje funksionojnë. Roli që kanë financat dhe sistemi financiar (përfshirë bankat, njërmjetësit e tjerë financiarë dhe bankën qendrore) në ekonominë e vendit do të diskutohet po ashtu në mënyrë integrale përgjatë lëndës. Investimet janë një tjetër disiplinë e rëndësishme, e cila do të diskutohet. Kursimet, normat e interesit dhe llogaritë rrjedhëse të fondeve janë po ashtu tema të rëndësishme që preken gjatë lëndës.					
<b>Objektivat</b>		Objektivi i kësaj lënde është të ofrojë një prezantim gjithëpërfshirës të parimeve themelore të financës, me theks në temat në fushën e financave të korporatave. Konceptet e zhvilluara në këtë kurs formojnë bazën për të gjitha kurset e njëpasnjëshme të financave, të tilla si investimet dhe financat e korporatave. Pas kursit, studentët pritet që: (1) të konsolidojnë konceptet themelore të financës të përfshira në kurs për t'u përgatitur për studimin e mëtejshëm në financë; (2) zhvillojnë aftësinë për zgjidhjen e problemeve me filozofinë e financës në mënyrë që ata të mund të trajtojnë problemet financiare në një mjedis të ri me mjetet dhe teknikat e mësuara nga kursi.					
<b>Konceptet Kryesore</b>		-norma e interesit -obligacione dhe tituj pronësie -flukset rrjedhëse -tregje financiare -vlera në kohë e parasë -risiku -kthimi					
Programi i Lëndës							
Java	Tema						
1	Prezantim Silabusi Prezantim me Lëndën, Mënyrën e Vlerësimit dhe Tekstin respektiv						
2	Kapitulli 1- Hyrje në financë Ky kapitull synon të qartësojë objektivat e një firme dhe të përshkruaj rolin e financës në një biznes; të bëjë një ndarje midis formave ligjore të firmave dhe të shpjegojë parimet bazë të financës, rëndësinë e tyre dhe rëndësinë e etikës dhe bësimit. (Bazat e Financës: Logjika dhe Praktika e Menaxhimit Financiar, Edicioni i 10-të. Arthur J.Keown, John D. Martin, J.William Petty. Seritë e Pearson në Financë, 2020. Kapitulli I. Faqe 26- 45.)						
3	Kapitulli II- Tregjet Financiare dhe normat e Interesit Ky kapitull përshkruan komponentët bazë të sistemit të tregut financiar, shpjegon mënyrën sesi ngrihen fondet në tregjet e kapitalit, jep njohuri mbi normat e kthimit dhe qartëson bazat e përcaktimit të normave të interesit dhe teoritë e njohura të strukturave të normave të interesit. (Bazat e Financës: Logjika dhe Praktika e Menaxhimit Financiar, Edicioni i 10-të. Arthur J.Keown, John D. Martin, J.William Petty. Seritë e Pearson në Financë, 2020. Kapitulli II. Faqe 46- 77.)						
4	Kapitulli III – Kuptimi i Pasqyrave Financiare dhe Llogarive Rrjedhëse (Pjesa e I) Si fillim kapitulli bën një prezantim të dy pasqyrave kryesore: Bilanzin dhe Pasqyra e të Ardhurave, me anë të të cilave më tej përcaktojmë pozicionin financiar dhe fitimin e një firme në një moment të caktuar. Objektivet tjetër e kapitullit është të mas llogarinë rrjedhëse dhe të shpjegojë diferencën midis GAAP dhe IFRS. Në pjesën e fundit të kapitullit jepet një përshkrim rreth limitimit të pasqyrave financiare dhe llogaritjeve të ndryshme të të ardhurave dhe te llogarive rrjedhëse. (Bazat e Financës: Logjika dhe Praktika e Menaxhimit Financiar, Edicioni i 10-të. Arthur J.Keown, John D. Martin, J.William Petty. Seritë e Pearson në Financë, 2020. Kapitulli III Faqe 78- 123.)						

<b>5</b>	Kapitulli III – Kuptimi i Pasqyrave Financiare dhe Llogarive Rrjedhëse (Pjesa e II) Si fillim kapitulli bën një prezantim të dy pasqyrave kryesore: Bilanzin dhe Pasqyra e të Ardhurave, me anë të të cilave më tej përcaktojmë pozicionin financiar dhe fitimin e një firma në një moment të caktuar. Objektivi tjetër e kapitullit është të mat llogarinë rrjedhëse dhe të shpjegojë diferencën midis GAAP dhe IFRS. Në pjesën e fundit të kapitullit jepet një përshkrim rreth limitimit të pasqyrave financiare dhe llogaritjeve të ndryshme të të ardhurave dhe te llogarive rrjedhëse. (Bazat e Financës: Logjika dhe Praktika e Menaxhimit Financar, Edicioni i 10-të. Arthur J.Keown, John D. Martin, J.William Petty. Seritë e Pearson në Financë, 2020. Kapitulli III Faqe 78- 123.)
<b>6</b>	Përsëritje e Kapitullit I, II, III Kuiz Nr.1 dhe Diskutime mbi zgjidhjen e Kuizit
<b>7</b>	Kapitulli IV – Vlerësimi i Përformancës Financiare të Firmës Ky kapitull shpjegon qëllimin dhe rëndësinë e analizave financiare; bën matjen e lidhjeve kryesore financiare sikurse dhe përdorimin e një bahskësie të dhënash për të vlerësuar përformancën e një kompanie; dhe si përfundim përshkruan limitimet e analizës së raporteve financiare. (Bazat e Financës: Logjika dhe Praktika e Menaxhimit Financar, Edicioni i 10-të. Arthur J.Keown, John D. Martin, J.William Petty. Seritë e Pearson në Financë, 2020. Kapitulli IV Faqe 130- 175.)
<b>8</b>	Provimi Gjysmë-final
<b>9</b>	Kapitulli V- Vlera në Kohë e Parasë Përmes këtij Kapitulli shpjegohet mekanizimi i interesit të përbërë dhe sjellja e vlerës së parasë në të tashmen; qartësohet e përvitshmja; përcaktohet vlera e ardhme apo e tashme e parasë dhe se si ti bëjmë të krahasueshme normat e interesit. (Bazat e Financës: Logjika dhe Praktika e Menaxhimit Financar, Edicioni i 10-të. Arthur J.Keown, John D. Martin, J.William Petty. Seritë e Pearson në Financë, 2020. Kapitulli V Faqe 176- 219.)
<b>10</b>	Kapitulli VI – Kuptimi dhe Matja e Riskut dhe Kthimit Si fillim jepet përcaktimi dhe matja e kthimit të pritshëm për një investim të vetëm si dhe matja e riskut përkatës; krahason lidhjen historike midis riskut dhe fitimit në tregun e kapitalit dhe shpjegon sesi investimet e diversifikuara ndikojnë në risk dhe fitimin e pritshëm. (Bazat e Financës: Logjika dhe Praktika e Menaxhimit Financar, Edicioni i 10-të. Arthur J.Keown, John D. Martin, J.William Petty. Seritë e Pearson në Financë, 2020. Kapitulli VI Faqe 220- 259.)
<b>11</b>	Kapitulli VII – Vlerësimi dhe Karakteristikat e Obligacioneve Bëhet dallimi midis llojeve të obligacioneve, jepet terminologjia dhe karakteristikat përkatëse; përcaktohet vlera dhe faktorët që e përcaktojnë atë; përshkruhet procesi bazë i vlerësimit të asetëve dhe vlerësimit të obligacioneve si dhe shpjegohen tre lidhje të rëndësishme që ekzitojnë në vlerësimin e obligacioneve. (Bazat e Financës: Logjika dhe Praktika e Menaxhimit Financar, Edicioni i 10-të. Arthur J.Keown, John D. Martin, J.William Petty. Seritë e Pearson në Financë, 2020. Kapitulli VII Faqe 260- 291.)
<b>12</b>	Kapitulli VIII – Vlerësimi dhe Karakteristikat e Titujve të Pronësisë Identifikim dhe vlerësimi i titujve të pronësisë të preferuar; identifikimi i karakteristikave bazë të titujve të pronësisë së përbahskët si dhe vlerësimi i tyre; llogaritja e normës së kthimit të pritshëm për zotëruesit e titujve. (Bazat e Financës: Logjika dhe Praktika e Menaxhimit Financar, Edicioni i 10-të. Arthur J.Keown, John D. Martin, J.William Petty. Seritë e Pearson në Financë, 2020. Kapitulli VIII Faqe 292- 317.)
<b>13</b>	Përsëritje e Kapitullit V, VI, VII, VIII Kuiz Nr.2 dhe Diskutime mbi zgjidhjen e Kuizit
<b>14</b>	Kapitulli IX – Kostoja e Kapitalit Përkufizimet dhe konceptet kryesore të kostos së kapitalit; vlerësimi dhe përcaktimi i burimit individual të kapitalit; llogaritja e mesatare të ponderuar të kostos së kapitalit të një firme; llogaritja e ndarjes së kostos së kapitalit. (Bazat e Financës: Logjika dhe Praktika e Menaxhimit Financar, Edicioni i 10-të. Arthur J.Keown, John D. Martin, J.William Petty. Seritë e Pearson në Financë, 2020. Kapitulli IX, Faqe 318- 349.)
<b>15</b>	Film A beautiful mind
<b>16</b>	Provim Final

<b>Parakushtet</b>	Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.
<b>Literatura</b>	• Foundations of Finance, 10th edition. Arthur J.Keown, John D. Martin, J. William Petty. Pearson Series in Finance, 2020
<b>Referenca të tjera</b>	• Fundamentals of Corporate Finance, 6th edition Published by Pearson (July 10, 2023) © 2024, Jonathan Berk, Peter DeMarzo, Jarrad Harford

### Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat

<b>1</b>	Konsolidim i njohurive rreth financës
<b>2</b>	Njohje e tregjeve financiare
<b>3</b>	Aftësim në matjen e performancës së firmës
<b>4</b>	Vendimmarrje racionale
<b>5</b>	Njohje dhe diferencim të instrumentave financiar

### Mënyra e Vlerësimit të Lëndës

Notat e Ndërmjetme	Sasia	Përqindja
Gjysmë finale	1	30
Kuize	2	20
Projekte	0	0
Projekte semestrale	0	0
Punë laborator	0	0
Pjesëmarrja në mësim	1	10
<b>Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final</b>		<b>60</b>
<b>Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final</b>		<b>40</b>
<b>Total</b>		<b>100</b>

### Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)

Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	4	64
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	2	28
Detyra	0	0	0
Gjysmë finale	1	11	11
Provimi final	1	12	12
Të tjera	2	5	10
<b>Ngarkesa totale e orëve</b>			<b>125</b>
<b>Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)</b>			<b>5.00</b>
<b>ECTS</b>			<b>5.00</b>